

MUHARREM GASHI

**RRETH DISA ASPEKTEVE TË EUFEMIZMAVE
NË TË FOLMET E PRIZRENIT DHE RRETHINËS SË TIJ**

Në të folmen e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij me interes janë edhe një numër fjalësh e shprehjesh të cilat përdoren mjaft dendur, madje edhe një numër sosh në kontekstin e papëlqyeshëm të thuhet hapur apo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky grup sintaksor i fjalëve përdoren për të shquar dukuri e përkufizime veprimesh që thjesht kuptohen, një numër tjetër përimtohen vetëm atëherë kur pasqyrohet rrethana a situata e përfuturit, si: *fikja fingsillve* (shuarja e thëngjillëve) kundër *syrin të keq* dhe *dëshirës jo të mirë* (Hoçë e Qytetit, Atmaxhë, Malësi e Vrrimit), *kqyrja e filxhanit*, Anadri, Zhur, *shikimi i trupit*, *shtypja e gjoksit dhe shpatullës*, *shenjat*, si në: Anadri, Vërri, Atmaxhë, etj. Në këto shprehje dalin përfytyrime figurash të ndryshme, si: *shqiponja*, *gjarpri*, *nëpërka*, *rrugët*, *zogu*, *ujku*, *pëllumbi*, *kryqi* etj. Kryqi dhe bërja e tij që kur fillon të shihet, por edhe kur përfundon *shikimi i filxhanit*. Padyshim se edhe këto shprehje kanë karakterin dhe simbolikën që *mëtojnë* të shënojnë: *fat*, *rrugë*, *dëshirë*, *dënim*, *gëzim*, *gjobitje a fitim*, *dashuri apo zënie të rrugës së dashurisë*, *mallkim*, *urim* etj.

Në rrjedhë të kohës dukuritë historiko-shoqërore lënë gjurmët e tyre në ligjërim¹, prandaj edhe eufemizmat nuk janë dukuri e të folurit të njerëzve të moshuar, të atyre pa shkollë ose me më pak shkollë, të atyre që mund t'i shquanim të mbetur sado pak prapa, gjegjësisht plakave, pleqve, burrave, fëmijëve, por ato i përdorin të gjithë, edhe të rinjtë edhe të rejtat, edhe nuset edhe dhëndurët, pra e gjithë shoqëria edhe ajo e shkolluar edhe ajo e prapambetur. Në këtë kontekst, një shprehje jo vetëm zbutëse, por edhe ironizuese e cila përdoret mjaft dendur në këto anë, por që për të njëjtën do të thonim edhe që nuk ka moshë është eufemizmi: *i pakanëm*, *e pakanëmne*, *të pakanëmnit*, *të pakanëmnet*: *Qy qy e pakanëmja!*, *Ej ej i pakanëmnit!* etj., pra ai që nuk ka pasuri, ai që është *i ngrat*, pra i dobët

¹ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, "Shtëpia Botuese e Librit Universitar", Tiranë, 2003, f. 274.

materialisht, i dobët me shëndet, në kundrimin edhe më të gjerë kryesisht shquan kuptimin e atyre që nuk kanë të kaluar të mirë, pastaj të atyre që nuk kanë traditë fisnike e bujare etj. Por gjithashtu edhe në këtë mënyrë nuk mungojnë aspektet ironizuese për ndonjë person e pse jo edhe për ndonjë familje që ndërkohë ka arritur të përparojë, ta ngrisë mirëqenien, pra të krijojë të mira materiale e shoqërore: *Ai që nuk o: kan' ku:rr nuk ka me kan'!* *Ajo familje që nuk o: kan' prap' nuk ka m'u ka:n'!* (Malësi e Vërrinit, Struzhje (Shtrungë), Atmaxhë).

Studiuesi ynë i mirënjohur, E Çabej, i cili i pari u mor me eufemizmat e shqipes shquan se pellgu kryesor i tyre është “*të folët e grave*”². Në këtë kontekst dëgjohet edhe thënia popullore në mbarë elementin shqiptar si dhe në këto anë: “*punë grash e fjalë grash*”. Ndryshe thënë, sot, ato janë risime të përditshme, në mjaft situata të nevojshme për të gjitha moshat, ose edhe më mirë të themi në shumë raste ballafaqimi mënyra veprimi të sjelljes në shoqëri me qëllim që t’i iket “zverdhjes së fytyrës” qoftë të fytyrës së vet a të bashkë biseduesit, ose ikjes nga ofendimi ndaj rrethit a dëgjuesit (Allan dhe Burridge 1991:11)³, po ky kundrim do të shprehet edhe nga antropologu, B. Malinovski, kur flet për natyrën shoqërore të të folurit⁴

Në vijim do të rendisim një numër fjalësh e shprehjesh që shquhen për karakterin e tyre eufemistik, gjë që dëshmojnë edhe në këtë këndvështrim se sa është e gjallë, sa e pasur e sa shprehëse dhe afektive është e folmja e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Ky ligjërim a të folur në kuptimin më të gjerë gjuhësor shquan një shpërfaqje dhe manifestim sa të aftësive shprehëse të komunikimit po kaq edhe të vetë trajtave të nduarnduarta të koncepteve të strukturës gjuhësore që shprehen qoftë me fraza e perifraza në këto areale të këtyre të folmeve që po i shqyrtojmë.

Kur një person dëmtohet në organet gjenitale në arealin e këtyre të folmeve përdoren një vister fjalësh e shprehjesh si: *u vra n'vete, u vra poshtë, u vra m'vete, u vra përfundi barkut, u vra n'vend të keq, u dund poshtë, u vra midis kamve, u vra n'mes, u vra midis kamve, u vra n'hije, u vra n'vehte, u vra n'luc* (Vërmicë) etj.

² E. Çabej, *Mbi disa eufemizma të shqipes*, “Studime Gjuhësore”, Prishtinë, 1978, vëllimi i IV, f. 68.

³ M. Ibrahim, *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmeve shqiptare*, Shkup, *Interlingua*, 2009, f. 31.

⁴ H. A. Richard, *Sociolinguistika*, “Dituria”, 2002, Tiranë, f. 124.

Rreth disa aspekteve të eufemizmave në të folmet e Prizrenit...

Për kryerjen e nevojës së vogël fiziologjike gjithashtu përdoren një numër fjalësh dhe shprehjesh, si: *me derdh ujë, bëre çulën, bëne çicin, bëne çishën, bëne nevojën e vogël, i jap kalit ujë, shko në avdesane, bëne shurrën* etj. Këto shprehje kryesisht për të vegjël, por edhe për të rritur: *shko në banjo, shko në dephane, shko të dalësh jashtë, shko ta lëshosh ujë, shko ta lëshosh ujin e vogël, bëne shurrën, po shkoj n'qenef, po shkoj në n'yz(d)yrhane* (Prizren), *po shkoj në n' abdesane, shko ku shkon mbreti në kambë, po shkoj në zyre, mu largu, me dal n'zyrhane, me dal n'fushë, po shkoj n'atë anë, po hi në mal, po shkoj n'pru* (në kuptimin: po shkoj në përrua që të bëj urinën) etj.

Për dhënien e qumështit nga nëna fëmijëve të vegjël përdoren edhe shprehjet: *i jap gji, i jap cicë, i jap me thith, i jap me pi, e n'koj djalin, e m'koj vajzën, fëmin', e mbaj në gji, e kam djalin n'prehër* etj.

Kur një grua është shtatzënë dëgjohen shprehjet: *asht shtatzen', asht me yzër, asht n(g)arkut, asht ner dit të veta, asht nër dit t'veta, ka hy n'mujin e vet, asht me barrë, asht e zan' në bark, asht ngarku(n)m, asht me bark, asht me loçkë, asht me dy shpirta, asht e zanë, asht ranë* etj. Për të kremten e përcjelljes së vajzës që bëhet nuse ka një numër jo të vogël fjalësh, si: *kanagjeqi, kanë-a, nata e kanagjeqit, nata e ndaljes, pritja, përcjellja*, ndërsa për natën kur bëhet nusja, gjegjësisht kur ajo e ngjet *kanën* (ngjyrën) përdoren: *nata e kanës, nata e bojës, nata e çiknisë, nata e vajznisë, nata e fundit e bajrakut nër çika, mbramja e kanës, mbramja e bojës* etj. Pra vajza, bija apo nusja që do të jetë nesër në shtëpi të burrit me të cilin martohet, i llakos gishtërinjtë si dhe i ngjyros flokët për t'u bërë edhe më e pëlqyeshme dhe më e këndshme.

Shprehjet zbutëse si pjesë a qasje tipike e gjuhës së grave duke shquar mëtimet e brendshme shpirtërore të tyre “që lindin pikërisht nga trysnia e shoqërores mbi gjuhësoren”⁵ pasqyrojnë dukuritë, situatat e rrethanat gjuhësore që janë të lidhura ngushtë me trashëgiminë kulturore nga një brez në tjetrin, doket e mendësinë e bashkësisë përkatëse shoqërore.

Për marrëdhëniet seksuale kur një person arrin të ketë me një person tjetër ose edhe me bashkëshorten e vet zakonisht përdoren një numër shprehjesh e togfjalësha foljorë, që një numër sosh shquajnë edhe nuanca moskuptimin nga të tjerët, si: *bëj seks, bëj dashuri, me bë punë, ndaj shtratin me burrë, ndau dyshekun me burrë, fjeti me burr, flejti n'dyshek me burrë, e aviti shtatin, e kapi grun, e preku grun, e zuni përfuni, i hypi*

⁵ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, “Shtëpia Botuese e Librit Universitar”, Tiranë, 2003, f. 241.

sipri, ia numroi shartet, ia futi m'rrojën (nga emërtimi i kafshës së kaut Murrojë,-a), ia mrruti, ia fuki, ia nreqi samarin, ia ngriti kamët, ia mlodhi kamët, ia lëmoi shpinën, ia kërrusi kurrizin, ndërroi shtat, ia bani punën, e iku, e rahatoi, e bani tutël, ia paloi drutë, ia paloi, ia lau kryt, u pastru, ia palloi, e shkërdheu, ia futi pa pyt, fleti me burr, ia krey punën, ia kallxoj punën etj.

Kur femrës i vinë menstruacionet për t'i ikur shprehjes e cila do të tingëllonte në mënyrë etike jo mirë nga bashkëbiseduesi ose të pranishmit përdor një varg shprehjesh të tjera që i shënjojnë ato, pra fare duke mos i zënë në gojë, si për shembull: *më kan ardh ato*, ose vetëm *ato*, *më kanë ardh të përmuajshmet*, ose vetëm *të përmuajshmet, mujoret, t'bardhat, të kuqet, teshat, renet*, por shumë rrallë *menstruacionet...*

Në këtë aspekt gjinia femërore përdor edhe një numër të konsiderueshëm shprehjesh që janë perifrazime më të stërholluara e metaforike për këtë fenomen femëror, si për shembull: *më kanë ardhur bojaxhitë, jam me bojë, jam n't'kuqe, ka ardh ushtria e kuqe, ka ardh tezja për vizitë, ka ardhur vithkuqi, kanë ardh renet, kanë ardh mujoret, ato të muajit, kanë ardh teshat, i kanë ardh xhaknat, jam në semafor, m'kanë ardh ato etj.*

Sikur edhe në elementin shqiptar, pothuajse në përgjithësi, ashtu edhe në arealet e të folmeve të Prizrenit dhe të rrethinës së tij kur ndokush vdes i ri dhe bie fjala për te nuk e përdorin emrin e tij në të folur, por e zëvendësojnë me fjalë zbutëse e herë me shprehje të ndjeshme që shquajnë për humbjen e të dashurve⁶, pra me eufemizma të ndryshëm, kryesisht me mbiemra ose edhe emra që shquajnë karaktere veti e cilësi, si p.sh: *i ngrati, i mjeri, i ziu, i shkreti, i gjori, ditëziu, i ndjeri, nafak ziu, e piu e zeza, shpirti i pastë rahmet, atij që shpirti i shkoftë në xhehnet, ai që i baftë dritë shpirti i tij, ai që i baftë dritë vorri, nur iu baftë vorri, pastë dheun e lehtë etj.*

Edhe për të moshuarin kur vdes nuk thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë se vdiq, por në vend të kësaj fjale përdoren shprehje zbutuese⁷ të ndryshme si: *ndërroi jetë, i pushoi shpirti, i pushoi zemra, vetëm u nda prej kësaj bote, shkoi në jetë të gjatë, shkoi n'garsonjerë (shtëpi e vogël, Prizren) shkoi n'bahqë të zotit (xhehnet), dha frymë, iu pre nafta, i erdhi mordja, e la fryma, i mbylli sytë, e pati kohën, e pati vaktin, e pagoi hashuren, e lau borxhin, i erdhi dakiki, i erdhi sahati, i erdhi koha e*

⁶ Gj. Shkurtaç, *Eufemizmat si shprehje e etnografisë së të folurit grarisht*, "Etnografi e të folurit të shqipës", Tiranë, 2015, f. 265.

⁷ Gj. Shkurtaç, *Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë*, në "Studime filologjike", 1977, nr. 2, f. 55.

Rreth disa aspekteve të eufemizmave në të folmet e Prizrenit...

vet, e thirri nana e vet, shkoi n'bahqe të zotit (xhehnet), shkoi te baba i vet, shkoi te i biri, u bashkua me vllazën, shkoi n'xhehnet, shkoi te axha që e ka dasht shumë, shkoi te i biri se s'mund t'rrike pa te, shkoi te Qarri i Kolukve (Vërmicë), ngase në varreza ndodhet një lis qarri), shkoi te Guri Çeshmes (Prizren, në fund të varrezave të Prizrenit, gjegjësisht në anë të rrugës Prizren-Hoqë e Qytetit, ndodhet një Çezme e të Panjohurit, një çezme e moçme ku pinë ujë kalimtarët, dhuratë (hajrat) e rregulluar me gurë të gdhendur nga një person i panjohur), shkoi te Lisi i Madh (Qëndresë, Radobravë⁸, te varrezat e Qëndresës ndodhet një lis i madh), shkoi te Ara e Kushninit (Atmaxhë, sepse varrezat janë afër Arës së Kushninit), e mori zoti, e mori i madhi në shtëpi të vet, iu desht zotit dhe e mori, ai e deshti ai e mori, Zoti i madh pati nevojë dhe e mori etj.

Si gjithmonë në kuadër të këtyre shprehjeve zbutëse ka edhe pasqyrime të tilla që për nuanca të caktuara shprehin edhe emocione të ndryshme qoftë të kuptimit të mirë, qoftë edhe të kuptimeve të tjera. Në këtë aspekt nuk mungojnë edhe nota të ndryshme ironizuese pas vdekjes së ndonjë personi të caktuar. Edhe në arealet e këtyre të folmeve ka mjaft shprehje e fraza të këtilla. Ndër to ne po veçojmë disa nga to, si për shembull: *iu pre gazepi, iu pre e mira, iu pre nafaka, i hangër petllat e veta, i ruji dhent, i molli kepët, qaq e paska pas, shkoi me ba çerep, shkoi me mledh dredhza, shoki të baj çerepë, po ban çerepë, shkoi n'at jetë, shkoi n'at botë, i lau sahanat, i mori të ligat, i mori të këqijat, i la të këqijat, i bani kamët dru, shkoi sy hapun, i mbylli sytë, i mori t'vetat, i ngarkoi pelat, i mlodhi rraquet, i mlodhi kamët, iu sos buka, iu sos sheqeri, iu sos nafaka, iu sos krypa, iu sosën petllat, hypi n'aeroplan të drurit (fjala është për arkivolin i cili bartet me duar, pra pa e lëshuar fare në tokë deri në vendin e varrezave) etj.*

Në mënyrë ironike ndërrimi i jetës shquhet edhe me fraza të tjera të ndryshme si për shembull: *e pagoi hoxhën, e pagoi borxhin, e pagoi kusurin, harroi të marrë frymë, shkoi në shtëpinë e re, shkoi në shtëpinë e vet, shkoi me la sahana, shkoi me marue çerepë etj.*

Momente të caktuara në jetë bëjnë të shtrëngojnë nxitje të aspekteve me shprehje nga më të ndryshme që gjithashtu kanë të bëjnë edhe me ritin e vdekjes, sidomos në këto raste nuk ka urime, por shprehje që shquajnë ironi e mallkime nga më të ndryshmet, si për shembull: *ta dafsha hallvën* (me rastin e vdekjes së ndonjë personi, pas të gjitha riteve të përkushtimit,

⁸ Selman Bajrami (1948), mësimitdhënës i Gjuhës shqipe, banor i fshatit Qëndresë të Anadrinit, Prizren.

në fund të këtij riti, pra pas mbarimit të drekës së fundit që jepet për ushqim gatuhet edhe hallvë, e cila nënkupton se ky është ushqimi i fundit në nderim të të vdekurit.

Prandaj edhe shpesh po në këtë kuptim përdoret edhe shprehja ironike që mëton kuptimin e vdekjes): (*v*)*deksh jarabi, ta hangsha hallvën, ta bafsha vorrin, ta çelsha vorrin, të shtifsha gjallë në vorr, të shtifsha n'dhe, ta mshelsha vorrin, ta nreqsha vorrin, ta pufsha çefinin, ta blefsha çefinin, ta vufsha gurin te krevi, ta vufsha cungin te krevi, ta vufsha kungllin te krevi, ta pshursha vorrin, ta dhefsha vorrin, ta vufsha gurin te Qarri i Kolukve⁹, ta çelsha gropën te Qeshmja e Gurit, t'qofsha te Lisi i Madh, t'pafsha te Ara e Kushninit etj.*, pra në përgjithësimin e këtyre kuptimeve: të pafsha në varreza, pra të vdekur.

Për sëmundjen e epilepsisë që është mjaft e përhapur dhe që nuk ka emërtim të përveçëm në të gjitha arealet e këtyre të folmeve, natyrisht duke mos e marrë këtu parasysh emërtimin e shkencës së mjekësisë, epilepsi, që do ta kishin më për afërt në shprehje, dëgjohen numër i konsiderueshëm i varianteve në këto anë të të folmeve të Prizrenit me rrethinë. Meqenëse është sëmundje mjaft e rëndë, e rrezikshme, shpesh emërtimet dalin nga situatat më të papritura, nga këndeje edhe në mënyra të ndryshme, pikërisht nga pasqyrimi i paraqitjes së momenteve, por që është i rëndësishëm në këto çaste, si: *ileti, e liga, e keqja, e paemnja, ajo e tokës, sëmundja e tokës, sëmundja e keqe, me ra në çetër punë, ra n'hall tjetër, sëmundja n(d)ryshe, e liga e ven(d)it, puna e trollit, e pahangrmja, e papanja, ajo pu:n, kokërdhakja*¹⁰, si për shembull në Mushnikovë të Grykës së Lumbardhit, Mushlak të Kabashit të Prizrenit, Gurrë (Poslisht), Mazrrek të Hasit të Prizrenit etj.

Ujku si gjithkund edhe nëpër vise të tjera shquhet për qenie të vendosur, të shpejtë, të shkathtë si dhe herë-herë të patrembur. Jo më kot ndër fjalët e urta të besimit tonë popullor është mjaft e përhapur: *asht' ujk, e ka qafën të trashë, e ka qafën e trashë si të ujkut!* Kuptimi i këtyre thënieve idiomatike vjen në shprehje sidomos kur ka të bëjë me persona që vetë i kryejnë punët pa ndihmën e tjetrit, në këtë aspekt më tutje, pra si ujku. Për ujkun gjithashtu përdoren një varg fjalësh, por që sinjifikojnë elemente e anë funksionale të vetë qenies, qoftë si të rrëmbyeshme, të shpejtë e të ashpër, si: *qafëholli, qafëgati, qafëtrashit etj.* (Has, Prizren).

⁹ Mehmet Sulaj (1949), mësues, banor i fshatit Vërmicë, Prizren.

¹⁰ A. Zymberi, *Fjalor popullor me rreth 2000 fjalë*, "Grafo-Loni", Prishtinë, 2014, f. 8.

Rreth disa aspekteve të eufemizmave në të folmet e Prizrenit...

gojëlidhuni, gojëmylli, gojëpremi, veshcurri, bishtgati, gojffarkuti, i pagoji, gojëmhelti, gojëmsheluni, i shpejti, kambshpeti, kamleti, kimeziu, sykuqi, dhamprem(n)i (Vërmicë) nafakliu, buzpremi, erëmadhi, nafakpremi, i urumi, bisha, bisha e egër, egërsia etj., kështu sa për ta ilustruar: Kushnin të Vërrinit, Kabash të Prizrenit etj.

Besimi ynë popullor në këtë pjesë të grupit të të folmeve verilindore të dialektit të gegërishtes është i pasur edhe me figura apo krijime të imagjinuara të atilla që shprehin në mënyrë të ndjeshme anën e mirë të qenieve, gjithashtu këto të mira shënjohej edhe me fraza, shprehje e fjalë të zgjedhura cilësisht për veti e karaktere të punës, për sjellje të mirë, humane dhe veprës së tyre të veçuar.

Identifikimi i këtyre qenieve me virtyte të urta e të buta që e shquajnë kryesisht mëshirën dhe mirësinë, në anën tjetër vetë prania, apo afria e tyre pasqyron ndjeshmërinë e fatit të mirë. Këto janë elemente që edhe populli ynë, e më shpesh, personat, njerëzit, përkatësisht figurat me karaktere të këtilla i krahason me engjëll, zana mali, madje, tash më vonë edhe me melaqe (meleke), pra kush i ka këto veti shquhet sa me nuanca përkëdheljeshe po aq edhe me përmasa vlerash të apostrofuara, si për shembull: *është engjëll, është hyri, asht perri, asht peri (Prizren), është zanë, është pëllumb, është gush pëllumbi, është mreteshë, është syzanë, asht fllanz', është thëll(ën)zë, asht shtathedhne, asht kumri, asht sorkadhe, është shqiponjë, është drenushë, është skifter, është drita e syrit, asht di(e)ll e hanë, është yll, është ylli që shndrit, asht hana pesëmdhjet, engjulli im, pllum'i im, zogza ime, drenusha ime, është melaqe, i ka melaqet etj.*

Edhe letërsia artistike është e pasur me figurën e Zanës: *"Eja oj zana e Malit.."* etj. Edhe në këto anë këto përfytyrime figurash shquhen për krijesa humane e pozitive, si për shembull: *shtojzovallet, zanat e malit, orët e malit, hijet e malit, t'mirat e malit, nuset e malit, hyritë, perritë, hyjnit e malit, hyjnit e natës, të mirat e jetës, të bekuemet e zotit, meleqet e zotit, të urtat e jetës, të mirat e jetës, të urumet e motit etj.*

Po për *shtojzovallet* në këto anë përdoren edhe një numër emrash i caktuar, në mesin edhe të ndonji tjetri edhe këto fjalë: *hyritë, hyjnitë, zanat, orët, melaqet*, si për shembull Shtrungë (Struzhje), Grazhdanik, Gurrë, Kabash, Has të Prizrenit etj.

Stigmatizimi për djallin, gjithsesi se shquan interesim e vëmendje, me ç'rast përdoren një numër i konsiderueshëm fjalësh e shprehjesh. Në këtë aspekt, kryesisht gratë e moshuara nuk e zënë në gojë fjalën që e emërton: *djallin*, emrin e djallit, apo edhe *dreqin*, madje edhe kur

ndonjëherë mund ta theksojnë nga ndonjë rrethanë të papritur, pendohen duke e përsëritur sintagmën: *uh tybe istikfa*, që në një kuptim don të thotë se është penduar që padashtas e ka përdorur emrin e djallit që nuk duhet të përdoret. Ngase, sipas mendësisë që shquajnë e në mënyrë më të veçantë këto gra, pra sidomos të moshuarat, ngase përdorimi i fjalës *djall*, apo edhe *dreq*, *shejtan* nuk është fat i mirë, sepse *me ta pre udhën kjo fjalë* as puna e as dita e as ndonjë gjë tjetër nuk do të kenë fat të mbarë në punët e ditës e as në secilën rrethanë tjetër të jetës.

Ndonjëherë edhe kur ngushtohen ta përdorin më parë thonë *ai koftlargo*, por kur bashkëbisedojnë tutje në këtë aspekt për emërtimin e *djallit*, apo të *dreqit* përdorin emërtime të tjera që janë të afërta, të cilat edhe mund të ndryshojnë nga mesi në mes jo vetëm në kuadër të këtyre arealeve të të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij, por edhe më gjerë. Më shpesh përdoren fjalët zbutëse, si për shembull *qoftlargo*, në Hoçë të Qytetit të Vërrinit, Atmaxhë, *ai i lugit t'keq*, në Vërmi (Vërmicë) të Prizrenit, pastaj: *shejtani*, *qafiri*, *largkofti*, *i ligu*, *koft larg ktu parni*, *ai koft larg ktuhit*, *largneshi*, *i biri i prronit*, ose *ai i kepave*, *ai i shkëmbijve*, *ai i prrojnave*, *ai i mallkuemi*, *ai i larmi*, *ai i malit*, *ai i kërshit*, *ai i natës*, si në Kabash të Prizrenit e Has, ndërsa më rrallë e ndonjë mes edhe shpesh përdoren edhe shprehjet si: *dreqi*, *i paudhi*, *shkoftlargo*, *ma i përhapuni*, *brinaqi*, *tybeistikfaja*, *syujku*, *sykeqi*, *ndjallakeqi*, *brinakeqi*, *shpirtligi*, *i pagoji*, *paduksi*, *i pakanmi*, *i kurkun[d]ni*, *i malit*, *i natës*, *i keqi*, *koft larg ven(d)it* etj.

Nga sa përimtuam në këtë shtjellim kemi trajtuar disa aspekte të fjalëve e të shprehjeve zbutëse ngase ka edhe mjaft fjalë e shprehje që e identifikojnë pasqyrimin më të gjithanshëm të fushës eufemistike në këto areale. Në mënyrë të veçantë këtu i kemi parasysh trajtat e dyta, gjegjësisht eufemizmat kur në vend të përdorimit të emrit të të atit shqiptohet emri i të birit që në komunikime të ndryshme, pra jo vetëm familjare kur është fjala për bashkëshortin: *babai i Xemit*, gjegjësisht *i zoti i shtëpisë*, *shtylla e shtëpisë*, pra bashkeshorti i asaj që shprehet e që për shkak se shquan turp, marre të e përdorë emrin e bashkëshortit për të cilin flet etj.

Gjithashtu shpërfaqet një përvijim i larmishëm i emërtimit me fjalë zbutëse për fekondimin e kafshëve, të egra e atyre shtëpiake: lopëve, pelave, deleve, dhive, derrave, arinjve, ujkonjave, hijenave etj., si: *mahen*, *buhen* e ndësehen për *ethen*, *përçiten*, *dbuhen*, *nerkehen*, *nërzehen*, *ndërzehen* etj. Në këtë kontekst të këtyre pasqyrimeve të kuptimeve të dyta të këtyre shprehjeve identifikohen nga kuptimet themelore të këtyre koncepteve, sidomos te fjalët: *nërkye-nërkehen* që dmth. kur kafsha e

humb baraspeshën apo drejtpeshimin e saj, pastaj *nërsehen- ndërsehen* që gjithashtu nënkupton nxitjen e turrjen e kafshës në një drejtim, veçanërisht të qenit etj. Tutje në këtë aspekt, në mënyrë të veçantë shquhet sidomos pasqyrimin më pikant e më i përkryer i së bukurës eufemistike: *bukla-bukul:bukur* etj.

PËRFUNDIM

Marrë në përvijimin më të përgjithshëm, njohja më e thelluar e lëndës gjuhësore padyshim se shquan lidhje dialektike të mjedisit me veçoritë dalluese dialektore, pokështu në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me të folmen e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Në të ardhmen, shpresojmë se do të rezultojnë studime e monografi përshkruese më të arrira si për të folme të veçanta, ashtu edhe për trajtime më të përgjithshme, qoftë edhe me fjalorë dialektorë. Tutje, gjithsesi se duke i vënë më afër këto aspekte të varianteve kuptimore të këtyre trajtave eufemistike padyshim se kemi bërë përpjekje për të vënë në rrugë të identifikimit shumësinë fjalësore të këtyre varianteve zbutëse që njëherit janë edhe trajta të lashta të thesarit të çmuar shqipfolës. Pra edhe këto të folme shquajnë të jenë fusha kërkimi për studime gjuhësore, sidomos për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët të tjera. Nga këndej gjuha shqipe duhet natyrshëm të mbëltojë më shumë fjalë e shprehje të herra nga të folmet e dialekteve për ta pasuruar edhe më fondin leksikor të gjuhës sonë.

BIBLIOGRAFI

- Ajeti, I. (1989) *Çështje të gjuhës letrare shqipe*, në “Studime gjuhësore në fushë të shqipes”, Rilindja, Prishtinë.
- Alen, K. & Burrige, K. (1991) *Euphemisms and Dysphemisms language used as a shield and weapon*, Oxford University Press.
- Badallaj, I. (1992) *Disa fenomene fonetike në të folmen e Hasit*, GJASSHF, 21-1991, Prishtinë.
- Beci, B. (2004) *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Çabej, E. (1977) *Disa eufemizma të shqipes*, “Studime gjuhësore”, 4, Prishtinë.
- Dodi, A. (1981) *Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar*, “Gjuha jonë”, I.
- Ibrahimi, M. (2009) *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*, “Interlingua”, Shkup.
- Memisha, V. (2011) *Studime për fjalën shqipe*, QSA, Tiranë.
- Murati, Q. (1996) *Drejtpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, Shkup.

- Osmani, T. & Pepa, S. (2000) *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Camaj-Pipa, Shkodër.
- Rawon, H. (1981) *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, New York; Crown publishers, Inc.
- Shkurtaj, Gj. (2003) *Sociolinguistika*, Tiranë.
- Shkurtaj, Gj. (2015) *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë.
- Thomaj, J. (1984) *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Zymberi, A. (1981) *Disa eufemizma dhe shprehje eufemistike popullore shqipe*, GJA, IX, Prishtinë.